12. Institucionet shtetërore nuk mund të kryejnë procedura prokurimi, me fonde publike apo të donatorëve, për krijimin e produkteve hartografike të një standardi me të ulët se produkti fotogrametrik, i përftuar nga fotografimi ajror, dixhital i territorit të Republikës së Shqipërisë.

13. Ngarkohet Ministri i Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

**VENDIM**
**Nr.347, datë 19.3.2008**

**PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR.382, DATË 20.5.1996 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR.8097, DATË 21.3.1996 "PËR PENSIONET SHTETËRORE SUPLEMENTARE TË PERSONAVE, QË KRYEJNË FUNKSIONE KUSHTETUESE, DHE TË PUNONJËSVE TË SHTETIT"", TË NDRYSHUAR"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të paragrafit të parë të nenit 29 të ligjit nr.8097, datë 20.5.1996 "Për pensionet shtetërore suplementare të personave, që kryejnë funksione kushtetuese, dhe të punonjësve të shtetit", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në listën, që i bashkëlidhet vendimit nr.382, datë 20.5.1996 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto shtesa:

1. Në nëntitullin "Për grupin e dytë", shkronja "a" e pikës 9 të nenit 1 të këtij ligji, në paragrafin "…dhe persona të tjerë, të barazuar me ta, si më poshtë:", bëhen këto shtesa:

"- Kryetari i Autoritetit të Konkurrencës;
- Anëtar i Komisionit të Konkurrencës të Autoritetit të Konkurrencës;
- Avokat i Prokurimeve;
- Kryeinspektor në Këshillin e Lartë të Drejtësisë;
- Shef kabineti në Gjykatën Kushtetuese;
- Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave;
- Anëtar i Grupit Mbikëqyrës të Shoqërive Huamarrëse.".

2. Në nëntitullin "Për grupin e dytë", shkronja "b" e pikës 9 të nenit 1 të këtij ligji, të bëhen këto shtesa:

"- Inspektor në Këshillin e Lartë të Drejtësisë;
- Këshilltar në Gjykatën Kushtetuese;
- Zëvendësdrejtor i Përgjithshëm i Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave.".

3. Në nëntitullin "Për grupin e dytë", shkronja "c" e pikës 9 të nenit 1 të këtij ligji, të bëhen këto shtesa:

a) Pas fjalëve "…drejtor drejtorie në Presidencë, Kuvend, Këshillin e Ministrave, ministri, institucione qendrore buxhetore, Kontrollin e Lartë të Shtetit, Këshillin e Lartë të Drejtësisë, institucionin e Avokaturës së Shtetit, institucionin e Avokatit të Popullit, Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Komisionin e Shërbimit Civil.", shtohen "…Autoritetin e Konkurrencës, Avokatin e Prokurimeve dhe Gjykatën Kushtetuese.".

b) Pas fjalëve "…shef sektori në Presidencë, Kuvend, Këshillin e Ministrave, ministri, institucione qendrore buxhetore, Kontrollin e Lartë të Shtetit, Këshillin e Lartë të Drejtësisë, institucionin e Avokaturës së Shtetit, institucionin e Avokatit të Popullit, Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Komisionin e Shërbimit Civil.", shtohen "…Autoritetin e Konkurrencës, Avokatin e Prokurimeve dhe Gjykatën Kushtetuese.".

4. Në nëntitullin "Për grupin e dytë", shkronja "d" e pikës 9 të nenit 1 të këtij ligji, të bëhen këto shtesa:

a) Pas fjalëve "…specialist në Presidencë, Kuvend, Këshillin e Ministrave, ministri, institucione qendrore buxhetore, Kontrollin e Lartë të Shtetit, Këshillin e Lartë të Drejtësisë, institucionin e Avokaturës së Shtetit, institucionin e Avokatit të Popullit, Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Komisionin e Shërbimit Civil.", shtohen "…Autoritetin e Konkurrencës, Avokatin e Prokurimeve dhe Gjykatën Kushtetuese.", si dhe emërtimet e mëposhtme:

"- Anëtar i Komitetit Shtetëror të Kulteve;
- sekretar i kryetarit të Gjykatës Kushtetuese;
- ndihmës ligjor në Gjykatën e Lartë.".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

**Sali Berisha**

**UDHËZIM**
**Nr.3, datë 12.3.2008**

**PËR TARIFAT E SHËRBIMIT PËR LICENCAT E PESHKIMIT**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, ligjit nr.7908, datë 5.4.1995 "Për peshkimin dhe akuakulturën", në zbatim të nenit 22 të rregullores nr.2, datë 17.5.2007 "Për licencimin e peshkimit dhe akuakulturës",

UDHËZOJ:

1. Angazhimet e inspektoratit të peshkimit dhe të bordit të licencave të aktivitetit të peshkimit pranë Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, për shqyrtimin e kërkesës dhe marrjen e vendimit për licencën e peshkimit, vlerësohen si shërbime ndaj të tretëve dhe paguhen nga kërkuesi në formën e tarifave të shërbimeve.

2. Vlera e tarifës përfshin shpenzimet administrative, si dhe gjithë veprimtaritë konkrete të inspektoratit të peshkimit dhe të ministrisë gjatë procesit të shqyrtimit të kërkesës për miratimin e licencës.

3. Tarifa e paguar është e pakthyeshme, pavarësisht nga fakti nëse kërkesa miratohet ose jo.

6. Tarifa derdhet nga kërkuesi në bankë, në adresën: Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Raiffeisen Bank, nr.llogarisë i ministrisë: 0104030780, me emërtimin "tarifë shërbimi për licencë peshkimi", sipas llojit të veprimtarisë së kërkuar.

8. Përcaktimi i tarifës së shërbimit bëhet mbi bazën e kohës dhe mjeteve të shpenzuara gjatë procesit të shqyrtimit dhe marrjes së vendimit.

9. Tarifat e shërbimit për licencat e peshkimit do të jenë:

a) Tarifa e shërbimit për licencë peshkimi detar me mjete lundruese me kuvertë do të jetë 3000 lekë.

b) Tarifa e shërbimit për licencë peshkimi bregdetar me mjete lundruese pa kuvertë do të jetë 2000 lekë.

c) Tarifa e shërbimit për licencë peshkimi në ujërat e brendshme do të jetë 3000 lekë.

d) Tarifa e shërbimit për licencë peshkimi me mjete fikse ose stacionare, si dhe për grumbullimin e molusqeve në bregdet ose laguna do të jetë 2000 lekë.

e) Tarifa e shërbimit për licencë akuakulture do të jetë 3000 lekë.

f) Tarifa e shërbimit për licencë peshkimi sportiv do të jetë 3000 lekë.

g) Tarifa e shërbimit për rinovimin e licencës do të jetë 1000 lekë.

h) Tarifa e shërbimit për transferimin e licencës do të jetë 1000 lekë.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I MJEDISIT, PYJEVE
DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE
**Lufter Xhuveli**

**URDHËR**
**Nr.301, datë 1.4.2008**

**PËR LICENCIMIN E AGJENCISË SË ADMINISTRIMIT KOLEKTIV TË SË DREJTËS SË AUTORIT NË FUSHËN E KINEMATOGRAFISË DHE TË VEPRAVE TË TJERA AUDIOVIZUALE "FMAA"**

Duke marrë parasysh dokumentet e mëposhtme, bashkëlidhur:

1. kërkesën dhe dosjen me dokumentacionin e agjencisë “FMAA”;

2. propozimin e Zyrës Shqiptare për të Drejtën e Autorit, nr.163, prot., datë 7.3.2008, për licencimin e kësaj agjencie në fushën e kinematografisë dhe të veprave të tjera të audiovizualit, për të ushtruar dhe mbrojtur të drejtat e autorëve krijues, regjisorë dhe skenaristë;

3. shkresën nr.1775/1, datë 17.3.2008 të Drejtorisë së Arteve dhe Letrave, mbi ligjshmërinë e kërkesës dhe dosjes,

konstatoj se, në përmbushje të detyrimeve ligjore që burojnë nga ligji nr.9380, datë 28.4.2005 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të”, është kompetencë e ministrit miratimi i dhënies së licencës së kësaj agjencie në fushën e kinematografisë.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës, të nenit 124, pika 1 të Kodit të Procedurave Administrative dhe të neneve 108, pika 1, dhe 109, pika 2 dhe 3 të ligjit nr.9380, datë 28.4.2005 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të”,

URDHËROJ:

1. Licencimin e Agjencisë së Administrimit Kolektiv të së Drejtës së Autorit “FMAA” në fushën e kinematografisë dhe të veprave të tjera të audiovizualit, për të ushtruar dhe mbrojtur të drejtat e autorëve krijues, regjisorë dhe skenaristë.

2. Muzika e kësaj fushe të ushtrohet dhe të mbrohet nga “Albautor”, agjencia për muzikën dhe regjistrimet mekanike të saj.

3. Afati i licencës është tre vjet nga hyrja në fuqi e këtij urdhri.

4. Urdhri i ministrit nr.66, datë 30.3.2004 revokohet.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I TURIZMIT, KULTURËS, RINISË
DHE SPORTEVE
**Ylli Pango**

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE**
**ZYRA SHQIPTARE PËR TË DREJTËN E AUTORIT**
**MINISTRI**

# LIÇENCË

**Nr. 2 Dt 01 / 04 2008**

Në mbështetje të ligjit nr 9380, dt 28.04.2005 *"Për të Drejtën e Autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të"* dhe V.K.M nr. 232, datë 19.04.2006 *"Për krijimin dhe funksionimin e Zyrës Shqiptare për të Drejtat e Autorit (ZSHDA)"*, mbasi konstatoi se dokumentacioni i paraqitur është në përputhje me kërkesat e përcaktuara në kuadrin ligjor në fuqi, Ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve,

## VENDOSI:

***Të liçensojë "FMAA"***, si Agjenci e Administrimit Kolektiv në fushën e kinematografisë dhe të veprave të tjera të audiovizualit, për të ushtruar dhe mbrojtur të drejtat e autorëve krijues, regjizorë dhe skenaristë. Muzika e kësaj fushe të ushtrohet dhe të mbrohet nga "Albautor", Agjencia për Muzikën dhe Regjistrimet mekanike të saj.

Ky subjekt është i njohur si person juridik me Vendim të Gjykatës së Tiranës, me nr. 600/1, datë 24.12.2007, si person i tatueshëm me numër NIPT K716300428, me seli: Rruga "Sami Frashëri", Pallatet "Agimi", shkalla nr. 19; Apartamenti nr. 338, Tiranë.

**Drejtues: Z. Piro MILKANI**
Liçenca është e vlefshme për një periudhë 3 (tre) vjeçare.
Kjo liçencë hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.
Liçenca duhet të ekspozohet në zyrat e agjencisë.

**MINISTRI**
**YLLI PANGO**

**VENDIM**
**Nr.24, datë 26.3.2008**

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES "PËR SISTEMIN E KONTROLLIT TË BRENDSHËM NË BANKAT DHE DEGËT E BANKAVE TË HUAJA"**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 1, pika 4, shkronja "b", nenit 12, shkronja "a", dhe të nenit 43, shkronja "c" të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", të ndryshuar; neneve 37, pika 2, shkronja "e", 38, 45, 46, 47, pika 3 të ligjit nr.9662, datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", si dhe pasi u njoh me propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Të miratojë rregulloren "Për sistemin e kontrollit të brendshëm në bankat dhe në degët e bankave të huaja", sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohen bankat dhe degët e bankave të huaja të kryejnë të gjitha ndryshimet përkatëse në aktet e brendshme rregullative, në përputhje me këtë vendim, jo më vonë se 90 ditë pas hyrjes në fuqi të tij.
3.Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes me ndjekjen e zbatimin e këtij vendimi.
4.Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integrimit Europian dhe Komunikimit, për publikimin e këtij vendimi në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë dhe në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.
5. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet udhëzimi "Për kontrollin e brendshëm në banka dhe degët e bankave të huaja", miratuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr.107, datë 3.11.1999.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

KRYETARI
**Ardian Fullani**

**RREGULLORE**
PËR SISTEMIN E KONTROLLIT TË BRENDSHËM NË BANKAT DHE DEGËT E BANKAVE TË HUAJA

KREU I
TË PËRGJITHSHME

Neni 1
**Objekti**

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave për organizimin dhe funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm të bankës dhe degës së bankës së huaj, strukturat dhe elementet e këtij sistemi, si dhe procedurat e mbikëqyrjes së funksionimit të tij nga Banka e Shqipërisë.

Neni 2
**Fusha e zbatimit**

Subjekte të kësaj rregulloreje janë bankat dhe degët e bankave të huaja, të cilat ushtrojnë veprimtari bankare dhe financiare në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me licencën e lëshuar nga Banka e Shqipërisë.

Neni 3

**Baza juridike**

Kjo rregullore hartohet në mbështetje të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", neni 12, pika "a", dhe ligjit nr.9662, datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë" neni 37, paragrafi 2, shkronja "e", neni 38, neni 45, neni 46 dhe neni 47, pika 3.

Neni 4
**Përkufizime**

1. Në zbatim dhe për efekt të kësaj rregulloreje termat e përdorur kanë të njëjtin kuptim me ata të përcaktuar në nenin 4 të ligjit "Për bankat në Republikën e Shqipërisë" dhe me aktet rregullative të Bankës së Shqipërisë.

2. Përveç sa parashikohet në pikën 1 të këtij neni, termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

a) "Sistemi i kontrollit të brendshëm" përfshin:

I. Procesin e monitorimit dhe të vlerësimit të vazhdueshëm të mjaftueshmërisë dhe efektivitetit të politikave, të procedurave dhe mekanizmave të kontrollit brenda një banke dhe të cilësisë së operacioneve të veprimtarisë së saj; të kryera nga strukturat e administrimit, drejtimit dhe kontrollit të bankës, si dhe nga personat që kryejnë funksionet e kontrollit të brendshëm;

II. Bashkërendimin e veprimtarisë së strukturave, të mekanizmave dhe procedurave të kontrollit që duhet të sigurojnë:

i) monitorimin e zbatimit të politikave të bankës, duke vlerësuar shkallën e realizimit të objektivave të shprehur në këto politika;

ii) vlerësimin e efektivitetit të veprimtarisë bankare dhe financiare të saj;

iii) identifikimin, matjen dhe monitorimin e nivelit të rreziqeve, si dhe parandalimin dhe administrimin efektiv të tyre;

iv) ruajtjen e aktiveve;

v) informacion të përshtatshëm, të saktë dhe të besueshëm të gjendjes financiare të bankës, administrimin e tij sipas procedurave të bankës; dhe

vi) përputhshmërinë me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, si dhe zbatimin e politikave, të rregullave dhe procedurave të brendshme, të miratuara nga këshilli drejtues ose drejtoria.

b) "Matrica e rrezikut" është tabela e hartuar nga vetë banka, për vlerësimin e rreziqeve të identifikuara në bankë, çdo rrezik vlerësohet duke pasur parasysh mundësinë e ndodhjes dhe shkallën e ndikimit në gjendjen financiare të bankës.

c) "Banka" është banka dhe dega e bankës së huaj e licencuar nga Banka e Shqipërisë, për të ushtruar veprimtari bankare dhe financiare.

d) "Sistemet TIK" janë sistemet e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit.

e) "Ligji "Për bankat"" është ligji nr.9662, datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë".

KREU II
SISTEMI I KONTROLLIT TË BRENDSHËM

Neni 5
**Strukturat e sistemit të kontrollit të brendshëm**

1. Strukturat kryesore përgjegjëse për realizimin e funksionit të kontrollit të brendshëm janë:

a) këshilli drejtues;

b) komiteti i kontrollit;

c) drejtoria dhe çdo strukturë tjetër drejtuese me karakter ekzekutiv në bankë;

d) njësia e kontrollit të brendshëm;

e) komitetet e veçanta, të ngritura me vendim të këshillit drejtues për trajtimin e çështjeve që kanë lidhje me kontrollin e brendshëm të bankës.

2. Strukturat e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni janë përgjegjëse për realizimin e funksionit të kontrollit të brendshëm, në përputhje me detyrat dhe kompetencat e përcaktuara në:

a) ligjin "Për bankat në Republikën e Shqipërisë" dhe/ose aktet nënligjore të Bankës së Shqipërisë të nxjerra në bazë dhe për zbatim të tij;

b) këtë rregullore;

c) statutin e bankës; si dhe

d) rregullat e miratuara nga këshilli drejtues ose drejtoria, mbi mënyrën e ushtrimit të funksioneve të sistemit të kontrollit të brendshëm.

Neni 6

**Kërkesa të përgjithshme**

1. Në miratimin e rregullave mbi mënyrën e ushtrimit të funksionit të kontrollit të brendshëm, këshilli drejtues i bankës merr parasysh:

a) vëllimin e aktivitetit të bankës;

b) llojshmërinë e operacioneve dhe nivelin e rreziqeve;

c) nivelin dhe fushën e kontrollit të ushtruar nga organet drejtuese të bankës;

d) përshtatshmërinë dhe saktësinë e regjistrimeve kontabël dhe të regjistrimeve të tjera.

2. Bankat sigurojnë veprimtari efektive të kontrollit të brendshëm duke e organizuar atë në mënyrë të mjaftueshme dhe të pavarur nga drejtoria dhe drejtuesit ekzekutivë të bankës.

Neni 7

**Elementet e sistemit të kontrollit**

Sistemi i kontrollit të brendshëm në banka përbëhet nga:

a) mbikëqyrja administrative (kontrolli administrativ);

b) kontrolli i administrimit të rrezikut; si dhe

c) raportimi dhe informacioni.

NËNKREU I

MBIKËQYRJA ADMINISTRATIVE

Neni 8

**Përgjegjësitë e këshillit drejtues**

1. Këshilli drejtues i bankës, në kuadër të mbikëqyrjes administrative, përveç përgjegjësive kryesore të përcaktuara në pikën 2 të nenit 37 të ligjit "Për bankat", miraton dhe rishikon periodikisht:

a) strukturën organizative, të administrimit dhe të funksionimit të bankës, sidomos të strukturave përgjegjëse për realizimin e funksionit të kontrollit të brendshëm, marrëdhëniet raportuese dhe kontrolluese brenda bankës;

b) rregullat dhe procedurat për përcaktimin e kufijve të kompetencave, delegimin e tyre dhe ndarjen e përgjegjësive për administratorët dhe punonjësit e bankës;

c) kompetencat për autorizimin, ndjekjen dhe raportimin e operacioneve të bankës;

d) rregullat dhe procedurat e brendshme për monitorimin e rreziqeve dhe vlerësimin e efektivitetit të procedurave dhe metodave për administrimin e tyre;

e) mënyrën e raportimit të mangësive (pamjaftueshmërive), të identifikuara në sistemin e kontrollit të brendshëm të bankës;

f) kodin e etikës dhe të trajtimit të konflikteve të interesit për administratorët dhe drejtuesit ekzekutivë të bankës;

g) rregullat mbi papajtueshmërinë dhe ndalimet në ushtrimin njëkohësisht të më shumë se një funksioni në lidhje me autorizimin, kryerjen dhe raportimin e operacioneve të bankës;

h) sistemin e kualifikimit (trajnimit), vlerësimit dhe motivimit të personelit në funksionet e kontrollit;

i) kompetenca të tjera, që i shërbejnë përmirësimit të funksionimit të sistemit të kontrollit të brendshëm.

2. Këshilli drejtues dhe/ose komiteti i kontrollit bën vlerësimin për punën e kryer dhe

përcakton shpërblimin e punonjësve të njësisë së kontrollit të bankës.

Neni 9

**Përgjegjësitë e drejtorisë së bankës**

Drejtoria, në kuadër të mbikëqyrjes administrative, ka përgjegjësitë e mëposhtme:

a) realizon drejtimin dhe kontrollin e përditshëm të veprimtarisë së bankës, duke zbatuar procedurat e përcaktuara nga këshilli drejtues për identifikimin, matjen, monitorimin dhe kontrollin e rreziqeve me të cilat përballet banka;

b) raporton në këshillin drejtues, të paktën 1 (një) herë në vit, mbi ecurinë e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe procedurën e vlerësimit të kërkesave për kapital të bankës;

c) siguron që njësia e kontrollit të brendshëm të informohet në kohë mbi zhvillimet, iniciativat, produktet e reja dhe ndryshimet operacionale, me qëllim identifikimin e rreziqeve në një periudhë sa më të hershme.

Neni 10

**Kërkesa të përgjithshme për njësinë e kontrollit të brendshëm**

1. Njësia e kontrollit të brendshëm është njësi organizative e veçantë e bankës, e pavarur nga veprimtaritë, strukturat dhe personat që ajo shqyrton ose kontrollon dhe e cila i raporton këshillit drejtues dhe/ose komitetit të kontrollit të bankës.

2. Çdo veprimtari, çdo departament, çdo degë ose njësi tjetër organizative e bankës, përfshihet në fushën e kontrollit të njësisë së kontrollit të brendshëm.

3. Njësia e kontrollit të brendshëm në degën e bankës së huaj organizohet nga banka mëmë në bazë të rregullave dhe procedurave të brendshme të saj, të përcaktuara nga organet drejtuese, si dhe në përshtatje me kërkesat e kësaj rregulloreje dhe akteve të tjera ligjore në fuqi.

Neni 11

**Anëtarët e njësisë së kontrollit të brendshëm**

1. Anëtarët e njësisë së kontrollit të brendshëm duhet të kenë aftësitë dhe cilësitë në një nga përcaktimet e mëposhtme:

a) aftësi profesionale në zbatimin e standardeve, të procedurave dhe teknikave të kontrollit në të gjitha fushat e aktivitetit të bankës;

b) njohje dhe/ose përvojë në zbatimin e standardeve të kontabilitetit;

c) njohje të parimeve të administrimit të rrezikut dhe teknikave të kujdesshme bankare.

2. Anëtarët e njësisë së kontrollit të brendshëm zbatojnë parimet dhe praktikat më të mira të drejtimit etik dhe karakterizohen nga standardet më të mira etike në kontaktet dhe marrëdhëniet e tyre me të tretët.

Neni 12

**Detyrat dhe përgjegjësitë e drejtuesit të njësisë së kontrollit të brendshëm**

1. Në funksionin e drejtuesit të njësisë së kontrollit të brendshëm zgjidhet një person me reputacion të lartë etik dhe profesional, si dhe me përvojë të mjaftueshme në fushën bankare dhe të kontrollit. Ai plotëson të gjitha kërkesat për administratorët, të përcaktuara në aktet rregullative të Bankës së Shqipërisë.

2. Drejtuesi i njësisë së kontrollit siguron dhe mbikëqyr zbatimin e parimeve dhe të standardeve të praktikës profesionale të kontrollit të brendshëm dhe eficiencën e veprimtarisë së

njësisë së kontrollit të brendshëm.

3. Drejtuesi i njësisë së kontrollit të brendshëm miraton programet për kryerjen e detyrave të detajuara të kontrollit, në zbatim të planit vjetor të veprimtarisë së njësisë së kontrollit të brendshëm.

Neni 13

**Rregullat e brendshme të njësisë së kontrollit të brendshëm**

1. Këshilli drejtues miraton planet vjetore të veprimtarisë së njësisë së kontrollit të brendshëm.

2. Rregullat e brendshme, që përcaktojnë mënyrën e funksionimit dhe të ushtrimit të veprimtarisë së njësisë së kontrollit të brendshëm, duhet të sigurojnë:

a) pavarësi në vendimmarrjen e drejtuesit të njësisë së kontrollit të brendshëm, në planifikimin dhe përcaktimin e kontrolleve;

b) mundësi përdorimi të pakufizuar të të dhënave mbi aktivet dhe të çdo informacioni tjetër të nevojshëm;

c) kontakt të drejtpërdrejtë të drejtuesit të njësisë së kontrollit të brendshëm me organet drejtuese;

d) shmangien e çdo konflikti të interesave në kryerjen e detyrave të kontrollit të brendshëm;

e) kushtet për pranimin (marrjen) në punë të ekspertëve në kryerjen e veprimeve të veçanta të kontrollit.

Neni 14

**Detyrat e njësisë së kontrollit të brendshëm**

1. Njësia e kontrollit të brendshëm, në kryerjen e funksioneve të saj, kontrollon dhe vlerëson ndër të tjera:

a) sistemet e informacionit dhe raportimit, duke përfshirë sistemin elektronik të informacionit dhe shërbimet elektronike bankare, sistemet e teknologjisë dhe informacionit dhe saktësinë e të dhënave;

b) përputhshmërinë e veprimtarisë së bankës me ligjet dhe aktet nënligjore, zbatimin e politikave, të rregulloreve dhe procedurave të brendshme, si dhe realizimin e objektivave të vendosur nga organet drejtuese;

c) efiçencën dhe efektivitetin e përgjithshëm të veprimtarisë së bankës;

d) sistemet e administrimit të rrezikut të zbatuara nga banka, metodën e krijuar për monitorimin e përputhshmërisë me politikat e brendshme të kapitalit, si dhe normat mbikëqyrëse të vendosura nga Banka e Shqipërisë;

e) besueshmërinë dhe paraqitjen në kohë të raporteve të kërkuara nga Banka e Shqipërisë;

f) nëse aktivet e bankës janë të mbrojtura siç duhet nga mashtrimet dhe papërgjegjshmëria në përdorimin e tyre;

g) zbatimin e procedurave për ndjekjen e kontratave dhe angazhimeve të bankës nga njësitë përkatëse;

h) zbatimin e procedurave të pranimit (marrjes) në punë të punonjësve dhe kualifikimit të personelit; si dhe

i) përshtatshmërinë e përshkrimeve në manualet e punës me detyrat e përcaktuara.

2. Në kryerjen e veprimtarive të tyre punonjësit e njësisë së kontrollit të brendshëm kanë të drejtë:

a) të përdorin çdo regjistrim, dosje ose të dhëna të bankës, përfshirë vendimet e organeve drejtuese të bankës dhe drejtuesve ekzekutivë, si dhe sistemet e informacionit dhe të kontabilitetit;

b) të kërkojnë dhe mbledhin raporte dhe dokumente të tjera, për të kryer ekzaminimin në lidhje me detyrat e caktuara;

c) të propozojnë marrjen në punë, sipas procedurave të brendshme, të ekspertëve për kryerjen e veprimeve të veçanta të kontrollit.

3. Rishikimet dhe veprimet e kontrollit të ndërmarra nga administratorët apo persona të tjerë nga personeli drejtues, brenda kompetencave të tyre, nuk mund të zëvendësojnë funksionet e njësisë së

kontrollit të brendshëm.

Neni 15

**Organizimi, drejtimi dhe struktura e njësisë së kontrollit të brendshëm**

1. Struktura e njësisë së kontrollit të brendshëm miratohet nga këshilli drejtues i bankës.

2. Njësia e kontrollit të brendshëm të degës së bankës së huaj përbëhet nga jo më pak se 2 (dy) anëtarë, të emëruar nga organet vendimmarrëse të bankës së huaj (mëmë).

3. Drejtues i njësisë së kontrollit të brendshëm në degën e bankës së huaj, mund të jetë drejtuesi i departamentit të kontrollit të brendshëm të bankës mëmë ose një person tjetër, i emëruar nga organet përkatëse drejtuese të bankës mëmë dhe i miratuar nga Banka e Shqipërisë.

Neni 16

**Dokumentimi i veprimtarisë së kontrollit dhe raportimi i rezultateve**

1. Njësia e kontrollit të brendshëm përgatit një raport për çdo kontroll të kryer. Raporti i kontrollit duhet të përmbajë të paktën:

a) objektin e kontrollit;

b) programin e punës së kontrollit (përshkrimin e metodologjisë, hapat dhe procedurat e ndjekura për të arritur objektivat e kontrollit);

c) gjetjet e kontrollit;

d) komentet e drejtuesve përgjegjës të njësisë së kontrolluar për gjetjet e kontrollit;

e) vlerësime për kualifikimin e personelit, mjaftueshmërinë e akteve të brendshme rregullative dhe sistemet e vlerësimit të rrezikut, sipas rasteve përkatëse;

f) rekomandime për korrigjimin dhe përmirësimet e gjetjeve, të vërejtura gjatë aktit të kontrollit; si dhe

g) zbatimin e rekomandimeve të lëna nga kontrollet e mëparshme.

2. Raportet dhe dokumentet e përgatitura dhe të mbledhura nga anëtarët e njësisë së kontrollit të brendshëm miratohen nga drejtuesi i njësisë së kontrollit të brendshëm, bazuar në procedurat e brendshme.

3. Gjatë procesit të kontrollit duhet t'i kushtohet kujdes dokumentimit dhe mbajtjes së evidencës së punës së njësisë së kontrollit të brendshëm, në mënyrë që informacioni i mbledhur të mbështesë gjetjet, vlerësimet dhe rekomandimet e bëra.

4. Raporti i kontrollit, i përgatitur sipas pikës 1 të këtij neni, i paraqitet drejtuesit të njësisë të kontrolluar nga drejtuesi i njësisë së kontrollit të brendshëm.

5. Drejtuesi i njësisë së kontrolluar paraqet shpjegimet dhe/ose pretendimet lidhur me gjetjet dhe rekomandimet e parashtruara, brenda afateve të përcaktuara në rregullat e brendshme të bankës.

6. Anëtarët e njësisë së kontrollit të brendshëm paraqesin konkluzione mbi secilin nga rekomandimet e parashtruara, për të cilat ka dhënë shpjegime ose pretendime me shkrim drejtuesi i njësisë së kontrolluar.

7. Në zbatim të procedurave të mësipërme, drejtuesi i njësisë së kontrollit të brendshëm paraqet raportin përfundimtar dhe dokumentet, sipas pikave 5 dhe 6 të këtij neni, në organet drejtuese përkatëse të bankës, sipas mënyrës së përcaktuar nga këshilli drejtues ose nga organet e tjera vendimmarrëse të bankës.

8. Organet drejtuese dhe administratorët, bazuar në gjetjet dhe rekomandimet e raportit të njësisë së kontrollit të brendshëm, vendosin nëse është e nevojshme për masa korrektuese dhe njoftojnë për to drejtuesin e njësisë së kontrollit dhe të strukturës së bankës së ngarkuar me zbatimin e tyre.

9. Këshilli drejtues i bankës analizon raportet e njësisë së kontrollit të brendshëm jo më pak se 1(një) herë në 6(gjashtë) muaj.

10. Komiteti i kontrollit kontrollon dhe mbikëqyr zbatimin e të gjitha detyrave të përcaktuara nga këshilli drejtues i bankës, në lidhje me gjithë problematikën e paraqitur në raportet e njësisë së kontrollit të brendshëm.

11. Drejtori i përgjithshëm dhe drejtuesit e departamenteve përkatëse koordinojnë punën për zbatimin e të gjitha masave korrektuese, të përcaktuara nga organet drejtuese të bankës, në zbatim të

vërejtjeve dhe rekomandimeve të paraqitura në raportin e njësisë së kontrollit të brendshëm.

Neni 17
**Plani i punës i njësisë së kontrollit të brendshëm**

1. Në fund të çdo viti, njësia e kontrollit të brendshëm përgatit planin e punës për vitin e ardhshëm, i cili paraqitet për miratim në këshillin drejtues të bankës.

2. Të gjitha njësitë e bankës janë objekt kontrolli nga njësia e kontrollit të brendshëm të paktën çdo 2(dy) vjet. Frekuenca e veprimeve të kontrollit, lidhur me njësitë individuale dhe sistemet e kontrollit, përcaktohet në përshtatje me rrezikun e mundshëm dhe madhësinë e tij për bankën.

3. Plani i punës bazohet në analizën e rrezikut të të gjithë veprimtarisë dhe njësive (strukturave) të bankës dhe konsideron shkallën e rrezikut në veprimtarinë e bankës, zhvillimet dhe risitë e, në veçanti, shkallën më të lartë të rrezikut të veprimtarive të reja.

Neni 18
**Raporti vjetor i njësisë së kontrollit të brendshëm**

1. Drejtuesi i njësisë së kontrollit të brendshëm paraqet një raport vjetor mbi punën e njësisë së kontrollit të brendshëm tek organet drejtuese përkatëse të bankës (këshilli drejtues, komiteti i kontrollit dhe drejtori i përgjithshëm i bankës), sipas mënyrës së përcaktuar nga këshilli drejtues ose nga organet vendimmarrëse të bankës së huaj (asambleja e aksionarëve, këshilli drejtues etj.) në rastin e degës së bankës së huaj.

2. Raporti vjetor paraqet rezultatet kryesore të veprimtarisë së njësisë së kontrollit të brendshëm, rekomandimeve të parashtruara, masave korrektuese të përcaktuara në bazë të rekomandimeve, si dhe nivelin e zbatimit të tyre.

NËNKREU II
KONTROLLI I ADMINISTRIMIT TË RREZIKUT

Neni 19
**Qëllimi**

1. Qëllimi i procesit të kontrollit të administrimit të rrezikut është të identifikojë ekspozimin e bankës ndaj tërësisë së rreziqeve, si dhe të kryejë matjen, administrimin dhe monitorimin e nivelit të tyre.

2. Banka harton dhe vë në zbatim, si pjesë e sistemit të kontrollit të brendshëm, metoda dhe procedura të kontrollit të administrimit të rrezikut, që përfshijnë:

a) përcaktimin e të gjitha llojeve të rreziqeve karakteristike, të matshme apo të pamatshme të bankës në terma sasiorë, duke identifikuar faktorët e brendshëm ose të jashtëm të rrezikut;

b) kuadrin e administrimit të rrezikut, duke përfshirë modelet e vlerësimit të rrezikut;

c) rishikimet e rregullta të matricës së përgjithshme të rrezikut të bankës;

d) monitorimin dhe vlerësimin periodik të qëndrueshmërisë ndërmjet rregullave të brendshme për administrimin e rrezikut, kushteve të tregut dhe rregullave e normave të përcaktuara në ligjin "Për bankat" dhe atyre të vendosura nga Banka e Shqipërisë, në zbatim të ligjit dhe akteve nënligjore për administrimin e rrezikut;

e) afatet dhe procedurat për vlerësimin e rrezikut, përcaktimin dhe zbatimin e normave të ekspozimit ndaj rrezikut, si dhe planeve të pranueshme të rasteve të paparashikuara (kontigjencës);

f) llojin, strukturën dhe frekuencën e raportimeve të rrezikut brenda strukturave të bankës.

3. Bankat rishikojnë rregullisht metodat dhe procedurat për matjen e rreziqeve dhe përcaktimin e normave të ekspozimeve, për të verifikuar përshtatshmërinë e tyre në kuadrin e zhvillimeve dhe risive (novacioneve) në veprimtarinë e saj, përshtatshmërinë me mjedisin makroekonomik dhe me atë të tregut në të cilin vepron.

4. Në rishikimin e metodave dhe procedurave sipas pikës 3 të këtij neni, bankat verifikojnë edhe përshtatshmërinë e këtyre metodave dhe procedurave me ligjin "Për bankat" dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të ligjit nga Banka e Shqipërisë, lidhur me administrimin e rreziqeve.

NËNKREU III
RAPORTIMI DHE INFORMACIONI

Neni 20
**Procedurat e raportimit**

1. Banka harton dhe zbaton procedura të përshtatshme raportimi dhe komunikimi, të cilat krijojnë mundësi për përdorimin e informacionit sipas të drejtave të punonjësve të bankës, si dhe për lëvizjen e informacionit sipas linjave të mëposhtme:

a) nga poshtë - lart, në mënyrë që organet drejtuese të jenë në dijeni për operacionet, rreziqet dhe ecurinë e veprimtarisë aktuale të bankës;

b) nga lart - poshtë, për informimin e personelit rreth strategjive dhe objektivave të bankës, si dhe rreth politikës, rregullave dhe vendimeve të miratuara nga organet drejtuese, të cilat ndikojnë në detyrat dhe përgjegjësitë e tyre; dhe

c) në mënyrë horizontale, për të siguruar që informacioni është shpërndarë siç duhet ndërmjet strukturave të saj.

2. Banka regjistron, në sistemet e saj të brendshme, të gjitha transaksionet dhe operacionet në kohën e duhur, në mënyrë të plotë dhe në rend kronologjik, sipas procedurave të përcaktuara në aktet e saj të brendshme.

3. Banka dokumenton të gjitha transaksionet në dosje (file) letre dhe/ose elektronike, të klasifikuara sipas llojit të operacionit, klientit dhe kritereve të tjera të zgjedhura prej tyre. Dosjet e dokumenteve të bankës përmbajnë:

a) inventarin e dokumenteve në përbërje të dosjes;

b) dokumentet e brendshme të bankës, informacione, marrëveshje, kontrata etj.;

c) informacionin financiar dhe çdo informacion tjetër për klientelën dhe tregun;

d) informacione të një rëndësie të veçantë për bankën; dhe

e) dokumente të tjera.

Neni 21
**Mbrojtja e informacionit në sistemet TIK**

1. Organet drejtuese të bankës, me qëllim mbrojtjen e informacionit në përdorimin e sistemeve TIK, miratojnë procedura dhe përcaktojnë përgjegjësitë dhe detyrat që lidhen me:

a) zhvillimin, zbatimin dhe modifikimin e sistemeve TIK;

b) mirëmbajtjen e sistemeve TIK;

c) administrimin e sistemeve TIK; dhe

d) përdorimin e mbrojtjen e informacionit elektronik.

2. Sistemet TIK të bankës sigurojnë:

a) mundësi të duhura përdorimi të kufizuar të informacionit, në përshtatje me funksionin dhe përgjegjësitë e personelit sipas vendit/pozicionit të punës;

b) procedura për kryerjen e kontrolleve të mjaftueshme, përfshirë punën e njësisë së kontrollit të brendshëm dhe të ekspertit kontabël të miratuar.

3. Këshilli drejtues miraton politika të brendshme të përdorimit të sistemeve TIK, të cilat synojnë të parandalojnë dhe kufizojnë:

a) gabimet në fazat e modifikimit dhe zhvillimit të programeve (software), të administrimit të sistemit dhe përdorimit të të dhënave elektronike (database);

b) ndërprerjen e operacioneve për shkak të faktorëve të rastit, të brendshëm apo të jashtëm;

c) mashtrimet dhe mundësitë e përdorimit abuziv të informacionit.

4. Banka rishikon vazhdimisht procedurat dhe politikat e brendshme për përdorimin e

sistemeve TIK, në përshtatje me llojet e rreziqeve.

## KREU III
## PROCESI I MBIKËQYRJES

### Neni 22
### **Mbikëqyrja dhe masat mbikëqyrëse**

1. Departamenti i Mbikëqyrjes në Bankën e Shqipërisë vlerëson organizimin dhe efiçencën e sistemit të kontrollit të brendshëm në bankë dhe në rastet kur e gjykon të arsyeshme, mund të mbështetet në raportet e njësisë së kontrollit të brendshëm, në kryerjen e funksioneve të saj mbikëqyrëse.

2. Departamenti i Mbikëqyrjes në Bankën e Shqipërisë dhe drejtuesi i njësisë të kontrollit të brendshëm të bankës kryejnë periodikisht takime, diskutime dhe konsultime mbi rreziqet bankare, funksionimin e njësisë së kontrollit të brendshëm dhe gjetjet e saj veçanërisht në fushat që paraqesin një rrezik të rëndësishëm, masat për t'u marrë, si dhe lidhjet me ekspertët kontabël të jashtëm.

3. Drejtuesi i njësisë së kontrollit të brendshëm njofton këshillin drejtues dhe komitetin e kontrollit, çdo herë, kur konstaton se vendimet e marra nga administrimi i bankës janë në kundërshtim me dispozitat ligjore apo rregullatore, ose me procedurat dhe politikat e miratuara të bankës, të cilat mbartin rreziqe për bankën.

4. Këshilli drejtues paraqet në Bankën e Shqipërisë raportet vjetore mbi aktivitetin e njësisë së kontrollit të brendshëm, dhe me kërkesë të Bankës së Shqipërisë, raportet mbi kryerjen e kontrolleve dhe të aktiviteteve të tjera të kësaj njësie.

### Neni 23
### **Masat parandaluese dhe ndëshkimore**

Banka e Shqipërisë, në rast mosplotësimi të kërkesave të kësaj rregulloreje, vendos sanksionet e parashikuara në nenin 76, pika 1, shkronjat "ç" dhe "d", dhe në nenin 89, pika 3, shkronjat "b" dhe "c", të ligjit "Për bankat" dhe në aktet e tjera nënligjore në zbatim të tij.

KRYETARI I KËSHILLIT MBIKËQYRËS
**Ardian Fullani**

**Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare,** në adresën: Bulevardi "Zhan d'Ark", prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 04 258 472 (Kryeredaktori)
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2008 është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

| | |
|---|---|
| 1. KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË | 600 lekë |
| 2. REGJISTRAT E NOTERISË | 1000 lekë |

BOTIME TË REJA
(Të përditësuara gusht 2007)

| | |
|---|---|
| KODI PENAL | 210 lekë |
| KODI I PROCEDURËS PENALE | 332 lekë |
| KODI PENAL dhe KODI I PROCEDURËS PENALE (i bashkuar) | 542 lekë |
| KODI CIVIL | 408 lekë |
| KODI I PROCEDURËS CIVILE | 224 lekë |
| KODI I PUNËS | 138 lekë |
| KODI I FAMILJES | 244 lekë |
| KODI I PROCEDURËS ADMINISTRATIVE | 88 lekë |

- Vendime të Gjykatës Kushtetuese 700 lekë
- Vendime të Gjykatës së Lartë 1000 lekë
- Përmbledhje legjislacioni për nëpunësin civil 200 lekë
- Përmbledhje legjislacioni në fushën e tatimeve dhe taksave 273 lekë
- Përmbledhje e legjislacionit për pasuritë e paluajtshme
  (Vol. I -192 lekë; Vol. II – 168 lekë, Vol. III – 185 lekë)

Hyri në shtyp më 9.4.2008
Doli nga shtypi më 11.4.2008

| Tirazhi: 3300 copë | Formati: 61x86/8 |
|---|---|

Shtypshkronja "Ilar"
Tiranë, 2008

Çmimi 36 lekë